

**VENDIM**  
**Nr.1705, datë 29.12.2008**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR REGJISTRIMIN E TREGUESVE GJEOGRAFIKË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 177,180,182 e 202 të ligjit nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullore "Për regjistrimin e treguesve gjeografikë", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave për zbatimin e këtij vendimi.
  3. Urdhri nr.5, datë 5.12.1994 i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë "Rregulla për emërtimet e origjinës", shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**RREGULLORE**  
**PËR REGJISTRIMIN E TREGUESVE GJEOGRAFIKË**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Qëllimi
  - 1.1 Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave lidhur me:
    - a) paraqitjen e aplikimeve për regjistrimin e treguesve gjeografikë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM) dhe shqyrtimin e tyre nga DPPM;
    - b) paraqitjen dhe shqyrtimin e kundërshtimeve dhe apelimeve në Bordin e Apelit të DPPM lidhur me treguesit gjeografikë;
    - c) publikimin e të dhënave lidhur me treguesit gjeografikë në Buletinin e Pronësisë Industriale nga DPPM.
  2. Përkufizime
    - 2.1 Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
      - a) Emërtimi i origjinës është emri i një vendi, rajoni ose lokaliteti që shërben për të përcaktuar produktet që e kanë origjinën në atë vend, cilësitë, fama ose karakteristikat e tjera të cilave vijnë si rezultat i mjedisit gjeografik, faktorëve natyrorë dhe njerëzorë ose si rezultat i prodhimit, përpunimit dhe përgatitjes së produkteve në këtë zonë të veçantë gjeografike.
      - b) Tregues gjeografik është emri i një vendi, rajoni ose lokaliteti që shërben për të përcaktuar produktet që e kanë origjinën në atë vend, cilësia, reputacioni dhe karakteristikat e të cilit janë atribut i kësaj origjine gjeografike.
      - c) Ligji nënkupton ligjin nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale".
    3. Parime të përgjithshme
      - 3.1 Të drejtën për të aplikuar pranë DPPM për regjistrimin e një treguesi gjeografik e ka çdo person fizik ose juridik që prodhon, përpunon ose përgatit në një zonë të caktuar gjeografike produktin, për përcaktimin e të cilit përdoret treguesi gjeografik.
      - 3.2 DPPM shqyrton aplikimet e depozituara dhe lëshon njoftimet dhe aktet e tjera, në përputhje me dispozitat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje.
      - 3.3 Veprimet e DPPM-së lidhur me këto aplikime bazohen ekskluzivisht në dokumente të shkruara. Kërkesat dhe çdo lloj dokumentacioni tjetër që depozitohet pranë DPPM-së duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe të shtypura.

3.4 DPPM-ja krijon dhe administron bazën elektronike të të dhënave, ku ruhen të gjitha veprimet e kryera në lidhje me treguesit gjeografikë.

4. Llojet e aplikimeve

4.1 Llojet e aplikimeve që mund të depozitohen pranë DPPM-së lidhur me treguesit gjeografikë janë:

- a) Kërkesë për regjistrimin e treguesit gjeografik, nëpërmjet formularit FTG1 (aneksi 1 i rregullores);
- b) Kërkesë për ndryshimin e emrit të pronarit të treguesit gjeografik, nëpërmjet formularit FTG2 (aneksi 1 i rregullores);
- c) Kërkesë për ndryshimin e adresës së pronarit të treguesit gjeografik, nëpërmjet formularit FTG3 (aneksi 1 i rregullores);
- ç) Kërkesë për dorëheqje nga treguesi gjeografik i regjistruar, nëpërmjet formularit FTG4 (Aneksi 1 i rregullores);
- d) Kërkesë për kundërshtimin e regjistrimit të treguesit gjeografik të publikuar, nëpërmjet formularit FTG5 (aneksi 1 i rregullores);
- dh) Kërkesë për apelimin e vendimit të DPPM për refuzimin e aplikimit, nëpërmjet formularit FTG6 (aneksi 1 i rregullores).

## KREU II

### PARAQITJA E APLIKIMIT PËR REGJISTRIMIN E TREGUESIT GJEOGRAFIK

#### 1. Paraqitja e aplikimit

1.1 Aplikimi për regjistrimin e treguesit gjeografik bëhet nëpërmjet formularit FTG1, i cili nënshkruhet nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij dhe depozitohet pranë protokollit të DPPM-së. Formulari FTG1 mund t'i dërgohet DPPM-së edhe me postë ose me faks nga paraqitësi i kërkesës, ose përfaqësuesi i tij. Në rastin e dërgimit me faks, aplikanti duhet që, brenda një muaji nga data e dërgimit të faksit, të depozitojë pranë DPPM-së kërkesën në formën e saj origjinale, në të kundërt kërkesa konsiderohet si e paparaqitur.

1.2 Dosja e aplikimit shoqërohet me listën e dokumenteve të depozituara (indeksi i dosjes), e cila nënshkruhet nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij.

1.3 Aplikimi për regjistrimin e treguesit gjeografik bëhet në lidhje me një produkt të vetëm.

1.4 Zyra e protokollit të DPPM-së, ditën që merr në dorëzim formularin FTG1 për regjistrimin e një treguesi gjeografik, shënon mbi formular datën dhe orën e paraqitjes së kërkesës, si dhe numrin e kërkesës.

#### 2. Elementet thelbësore që përmban aplikimi

2.1 Në zbatim të nenit 182 të ligjit, aplikimi për regjistrimin e treguesit gjeografik duhet të përmbajë:

a) formularin FTG1 të nënshkruar nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij, i cili duhet të përmbajë në mënyrë të veçantë të dhënat mbi emrin dhe adresën e aplikantit, treguesin gjeografik, përcaktimin e produktit për të cilin do të përdoret treguesi gjeografik, si dhe përcaktimin e kufijve të lokalitetit gjeografik, ku prodhohet ose përpunohet produkti;

b) dokumentin e pagesës së tarifës së depozitimit;

c) një raport mbi vetitë dhe karakteristikat e produktit dhe lidhjen e tij me mjedisin e origjinën gjeografike;

ç) një dokument të lëshuar nga autoriteti kompetent, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, i cili përcakton kufijtë e zonës gjeografike, ku prodhohet ose përpunohet produkti;

d) një dokument të lëshuar nga autoriteti kompetent në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, i cili përcakton vetitë dhe karakteristikat e produktit, si dhe lidhjen ndërmjet vetive dhe karakteristikave të produktit me mjedisin gjeografik ose origjinën gjeografike, në përputhje me parashikimin e pikës 2 të nenit 177 të ligjit;

dh) një dokument të lëshuar nga autoritetet vendore, që vërteton kryerjen e veprimtarisë prodhuese të aplikantit në rajonin gjeografik të dhënë;

e) kur aplikanti është një person fizik ose juridik i huaj, dokumentin që vërteton regjistrimin e treguesit gjeografik në vendin e origjinës, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar;

ë) kur produkti është ushqimor ose bujqësor, një dokument të lëshuar nga autoriteti kompetent, i cili vërteton se produkti i përmbush të gjitha kriteret mbi cilësinë, të parashikuara nga legjislacioni përkatës në fuqi;

f) autorizimin e përfaqësimit, nëse aplikimi paraqitet nga përfaqësuesi i aplikantit. Autorizimi i përfaqësimit duhet të përmbajë nënshkrimin e aplikantit, dhe kur aplikanti është person juridik, edhe vulën e tij.

### KREU III EKZAMINIMI FORMAL I KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E TREGUESIT GJEOGRAFIK

#### 1. Rendi dhe afatet e ekzaminimit të aplikimit

1.1 Kërkesat për regjistrimin e treguesve gjeografikë ekzaminohen nga DPPM-ja sipas radhës së paraqitjes së tyre.

1.2 Një kërkesë ekzaminohet jashtë radhës, nëse ekziston një konflikt rreth shkeljes së të drejtave të treguesit gjeografik. Ekzaminimi jashtë radhës bëhet nga ekzaminuesi pasi aplikanti të paraqesë një kërkesë me shkrim dhe të paguajë tarifën përkatëse.

1.3 Ekzaminimi i aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik bëhet brenda periudhës 3-(muajore) nga data e paraqitjes së tij. Brenda kësaj periudhe ekzaminuesi shqyrton nëse aplikimi plotëson kushtet e nenit 182 të ligjit dhe pikës 2 të kreut II të kësaj rregulloreje.

#### 2. Ekzaminimi i aplikimit dhe njohja e datës së depozitimit

2.1 Nëse aplikimi i përmbush të gjitha kërkesat e nenit 182 të ligjit dhe të pikës 2 të kreut II të kësaj rregulloreje, DPPM-ja bën depozitimin e aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe i lëshon aplikantit dëshminë e depozitimit, duke njohur si datë depozitimi datën e paraqitjes së aplikimit.

2.2 Nëse aplikimi nuk i përmbush të gjitha kërkesat e nenit 182 të ligjit dhe të pikës 2 të kreut II të kësaj rregulloreje, DPPM-ja njofton aplikantin për të bërë plotësimet brenda 3 muajve nga data e njoftimit. Periudha për paraqitjen e plotësimeve mund të zgjatet deri në 1 muaj shtesë, nëse aplikanti paraqet me shkrim një kërkesë bazuar në shkaqe të arsyeshme dhe kundrejt pagesës së tarifës përkatëse. Në çdo rast, kërkesa për zgjatjen e afatit duhet të depozitohet pranë DPPM-së, pa mbaruar afati tremujor i caktuar për plotësimin e të metave të aplikimit.

2.3 Kur aplikanti i kryen plotësimet e kërkuara brenda kohës së caktuar, DPPM-ja depoziton aplikimin dhe i lëshon aplikantit dëshminë e depozitimit brenda 3 muajve nga data kur aplikanti ka plotësuar të metat e kërkesës, duke njohur si datë depozitimi të aplikimit datën e paraqitjes së tij.

2.4 Kur të metat e aplikimit kanë të bëjnë me emrin dhe adresën e aplikantit, treguesin gjeografik, produktin për të cilin regjistrohet treguesi ose me mospagesën e tarifës së depozitimit, datë depozitimi e aplikimit do të njihet data e plotësimit të të metave. Në rastin kur të metat lidhur me ndonjë prej elementeve të lartpërmendura konsistojnë në gabime të tilla që nuk cenojnë thelbin e këtyre elementeve, si datë depozitimi e kërkesës do të njihet data në të cilën aplikimi është paraqitur pranë DPPM-së.

2.5 Nëse aplikanti nuk i kryen plotësimet brenda afatit të caktuar, DPPM-ja e refuzon kërkesën për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe i lëshon aplikantit njoftimin e refuzimit të aplikimit.

#### 3. Dëshmia e depozitimit

##### 3.1 Dëshmia e depozitimit përmban të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin e treguesit gjeografik;
- b) emrin dhe adresën e aplikantit;
- c) datën e depozitimit dhe numrin e kërkesës;
- ç) produktin për të cilin mbrohet treguesi gjeografik.

### KREU IV EKZAMINIMI I APLIKIMIT NË LIDHJE ME BAZAT E REFUZIMIT DHE REGJISTRIMI I TREGUESIT GJEOGRAFIK

#### 1. Ekzaminimi në lidhje me shkaqet absolute për refuzim

1.1 Pas njohjes së datës së depozitimit, ekzaminuesi, brenda një periudhe tremujore nga data e lëshimit të dëshmisë së depozitimit, ekzaminon nëse aplikimi është në përputhje me kërkesat e e germave “a” dhe “b” të nenit 180 të ligjit.

1.2 Gjatë ekzaminimit, DPPM-ja mund t'i kërkojë aplikantit materiale dhe dokumente shtesë nëpërmjet një njoftimi me shkrim. Aplikanti duhet t'ia paraqesë DPPM-së dokumentet e kërkuara, brenda 2 muajve nga data e njoftimit, në të kundërt kërkesa refuzohet përfundimisht dhe paraqitësi i kërkesës njoftohet për refuzimin nëpërmjet një njoftimi me shkrim, ku paraqiten dhe arsyet e refuzimit të kërkesës.

1.3 Kur nga ekzaminimi i aplikimit rezulton se ai bie në kundërshtim me kërkesat e germave "a" dhe "b" të nenit 180 të ligjit, DPPM-ja e refuzon atë dhe njofton aplikantin nëpërmjet një njoftimi me shkrim, ku paraqiten arsyet e refuzimit të kërkesës.

## 2. Regjistrimi i treguesit gjeografik

2.1 Nëse brenda 3 muajve nga data e publikimit të aplikimit asnjë kundërshtim nuk është depozituar nga palët e treta kundër regjistrimit të treguesit gjeografik, DPPM-ja nxjerr njoftimin për pagesën e tarifës së regjistrimit dhe i kërkon aplikantit që, brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit, të bëjë pagesën e tarifës dhe një kopje të dokumentit të pagesës ta depozitojë pranë DPPM-së.

2.2 Nëse aplikanti nuk e paguan tarifën e regjistrimit brenda afatit të caktuar, DPPM-ja refuzon aplikimin dhe njofton me shkrim aplikantin.

2.3 Kur aplikanti e paguan tarifën e regjistrimit brenda afatit të caktuar, DPPM-ja e regjistron treguesin gjeografik në regjistrin përkatës dhe lëshon certifikatën e regjistrimit brenda një periudhe tremujore nga data e pagesës së tarifës.

2.4 DPPM-ja publikon treguesin gjeografik të regjistruar në Buletinin e Pronësisë Industriale.

3. Të dhënat që përmban certifikata e regjistrimit të treguesit gjeografik

3.1 Certifikata e regjistrimit të treguesit gjeografik duhet të përmbajë:

- a) emërtimin e treguesit gjeografik;
- b) emrin dhe adresën e pronarit të treguesit gjeografik;
- c) numrin e kërkesës dhe numrin e regjistrimit të tij;
- ç) datën e depozitimit dhe datën e regjistrimit;
- d) produktin për të cilin është regjistruar treguesi gjeografik.

4. Kryerja e ndryshimeve ose heqja dorë nga aplikimi

4.1 Kur aplikimi për regjistrimin e një treguesi gjeografik është në proces ekzaminimi dhe ka ndodhur ndryshimi i emrit dhe/ose adresës së aplikantit, DPPM-ja kundërshton depozitimin nga aplikanti të formularit përkatës, dokumenteve që provojnë ndryshimin e mësipërm dhe pagesës së tarifës përkatëse, e regjistron treguesin në regjistrin e treguesve gjeografikë me të dhënat e reja, pa ndryshuar datën e depozitimit të aplikimit.

4.2 Aplikanti ka të drejtë të heqë dorë nga aplikimi për regjistrimin e treguesit gjeografik, nëpërmjet një kërkesë me shkrim, për aq kohë sa ai nuk është regjistruar ende në regjistrin e treguesve gjeografikë. Me depozitimin e një kërkesë të tillë, aplikimi konsiderohet i tërhequr.

## KREU V

### PUBLIKIMET NË BULETININ E PRONËSISË INDUSTRIALE

#### 1. Llojet e publikimeve

1.1 DPPM-ja publikon në Buletinin e Pronësisë Industriale të dhënat mbi aplikimin për regjistrimin e treguesit gjeografik, regjistrimin e tij, ndryshimet në emrin dhe/ose adresën e pronarit të treguesit gjeografik, dorëheqjen dhe shfuqizimin e treguesit gjeografik.

2. Publikimi i aplikimeve dhe regjistrimeve të treguesve gjeografikë

2.1 Të dhënat që publikohen në Buletin për aplikimin janë:

- a) numri i kërkesës;
- b) data e depozitimit;
- c) emri dhe adresa e aplikantit;
- ç) emërtimi i treguesit gjeografik;
- d) produkti për të cilin mbrohet treguesi gjeografik.

2.2 Të dhënat që publikohen në Buletin për regjistrimin e treguesit gjeografik janë:

- a) numri i kërkesës dhe numri i regjistrimit;
- b) data e depozitimit;
- c) emri dhe adresa e aplikantit;
- ç) emërtimi i treguesit gjeografik;
- d) produkti për të cilin mbrohet treguesi gjeografik.

**KREU VI**  
**KUNDËRSHTIMI PËR REGJISTRIMIN E TREGUESIT GJEOGRAFIK**

**1. Paraqitja e kundërshtimit**

1.1 Kundërshtimi ndaj një aplikimi për regjistrimin e një treguesi gjeografik të publikuar, mund të paraqitet pranë DPPM-së, brenda një periudhe tremujore nga data e publikimit, për një nga shkaqet e parashikuara në germën "c" dhe "ç" të nenit 180 të ligjit ose për çdo shkak tjetër të ligjshëm, nëpërmjet depozitimit të dokumenteve të mëposhtme:

- a) formulari FTG5 për kundërshtimin e regjistrimit të treguesit gjeografik;
- b) dokumentin e pagesës së tarifës për kundërshtimin.

1.2 Kundërshtimi duhet të përmbajë edhe dokumentet e mëposhtme:

- a) autorizimin e përfaqësimit, në rast se kundërshtimi paraqitet nga përfaqësuesi i kundërshtuesit;
- b) dokumentet mbi të cilat kundërshtuesi bazon pretendimet e tij.

**2. Shqyrtimi i kundërshtimit nga bordi i apelimit**

2.1 Bordi i apelimit të DPPM-së e shqyrton kundërshtimin dhe merr vendim lidhur me të brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së tij.

2.2 Në rast se kundërshtimi nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga pika 1.1 e këtij kreu, bordi i apelimit e konsideron të paparaqitur kundërshtimin dhe njofton me shkrim kundërshtuesin.

2.3 Në rast se kundërshtimi nuk plotëson kërkesat e pikës 1.2 të këtij kreu, bordi i apelimit i kërkon kundërshtuesit, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, të plotësojë të metat brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, në të kundërt kundërshtimi quhet si i paparaqitur.

2.4 Kur kundërshtimi i plotëson të gjitha kërkesat e pikës 1 të këtij kreu, bordi i apelimit pranon për shqyrtim kundërshtimin dhe njofton me shkrim aplikantin e treguesit gjeografik kundër të cilit është depozituar kundërshtimi, duke i kërkuar atij që, brenda një muaji nga data e njoftimit, të depozitojë me shkrim pretendimet e tij lidhur me kundërshtimin dhe çdo dokument tjetër në mbështetje të pretendimeve të tij.

2.5 Gjatë shqyrtimit, bordi i apelimit ka të drejtë t'u kërkojë palëve, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, të paraqesin materiale dhe dokumente të tjera shtesë brenda një periudhe njëmujore nga data e njoftimit.

2.6 Bordi i apelimit merr vendim lidhur me kundërshtimin dhe njofton me shkrim palët. Vendimi i bordit të apelimit mund të apelohehet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

**3. Trajtimi i aplikimit pas marrjes së vendimit mbi kundërshtimin**

3.1 Kur bordi i apelimit vendos të rrëzojë kundërshtimin dhe vendimi nuk apelohehet në gjykatë, një kopje e vendimit të bordit depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe ekzaminuesi vazhdon procedurën e regjistrimit, në përputhje me parashikimet e ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

3.2 Kur bordi i apelimit vendos të pranojë kundërshtimin dhe vendimi nuk apelohehet në gjykatë, një kopje e vendimit të bordit depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe ekzaminuesi lëshon njoftimin e refuzimit të regjistrimit.

3.3 Në rast se vendimi i bordit të apelimit lidhur me kundërshtimin për regjistrimin e një treguesi gjeografik apelohehet në gjykatë, një kopje e vendimit përfundimtar të gjykatës depozitohet në dosjen e aplikimit dhe DPPM-ja refuzon ose regjistron treguesin gjeografik, në përputhje me vendimin e gjykatës.

**KREU VII**  
**NDRYSHIMI I EMRIT DHE/OSE ADRESËS SË PRONARIT**  
**TË TREGUESIT GJEOGRAFIK**

**1. Paraqitja e kërkesës**

1.1 Pronari i një treguesi gjeografik mund të kërkojë ndryshimin e emrit dhe/ose adresës së tij në regjistrin e treguesve gjeografikë. Kërkesa për ndryshimin e emrit paraqitet pranë DPPM-së, nëpërmjet formularit FTG2 dhe kërkesa për ndryshimin e adresës paraqitet nëpërmjet formularit FTG3.

1.2 Së bashku me kërkesën, aplikanti duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:

- a) dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse;
- b) autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të treguesit gjeografik;

c) në rastin kur kërkohet ndryshimi i emrit, dokumentin që vërteton këtë ndryshim.

2. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPM-ja

2.1 DPPM-ja shqyrton kërkesën për ndryshim emri ose adrese, nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 1 të këtij kreu dhe në rast ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 muajve nga data e njoftimit, në të kundërt kërkesa refuzohet.

2.2 DPPM-ja e regjistron ndryshimin e emrit ose adresës së pronarit të treguesit gjeografik në regjistrin e treguesve gjeografikë dhe njofton aplikantin për regjistrimin e ndryshimit, brenda 6 muajve nga data kur aplikimi plotëson të gjitha kërkesat e pikës 1 të këtij kreu. Ndryshimi publikohet në Buletinin e Pronësisë Industriale.

## KREU VIII

### REGJISTRIMI I DORËHEQJES NGA TREGUESI GJEOGRAFIK

1. Paraqitja e kërkesës

1.1 Kërkesa për regjistrimin e dorëheqjes nga treguesi gjeografik i regjistruar, paraqitet pranë DPPM-së nëpërmjet formularit FTG4 nga pronari i treguesit gjeografik.

1.2 Së bashku me formularin, aplikanti duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:

a) dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse;

b) autorizimin e përfaqësimit kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të treguesit gjeografik.

2. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPM-ja

2.1 DPPM-ja shqyrton kërkesën për dorëheqje, nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 1 të këtij Kreu dhe në rast ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 muajve nga data e njoftimit, në të kundërt kërkesa refuzohet.

2.2 DPPM-ja e regjistron dorëheqjen nga treguesi gjeografik në regjistrin e treguesve gjeografikë dhe njofton aplikantin për regjistrimin e dorëheqjes, brenda 6 muajve nga data kur aplikimi plotëson të gjitha kërkesat e pikës 1 të këtij kreu. Dorëheqja publikohet në Buletinin e Pronësisë Industriale.

## KREU IX

### APELIMET PRANË BORDIT TË APELIMIT

1. Paraqitja e apelimit

1.1 Brenda një periudhe dymujore nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin e një aplikimi, aplikanti ka të drejtë të apelojë vendimin e DPPM-së në bordin e apelimit, duke depozituar pranë DPPM-së:

a) formularin e apelimit FTG6, të nënshkruar nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij;

b) dokumentin e pagesës së tarifës për apelimin;

c) autorizimin e përfaqësimit nëse apelimi paraqitet nga përfaqësuesi i aplikantit.

2. Shqyrtimi i apelimit nga bordi i apelimit të DPPM

2.1 Bordi i apelimit shqyrton paraprakisht nëse apelimi përmbush kërkesat e pikës 1.1 të këtij kreu dhe nëse këto kërkesa nuk janë përmbushur, bordi i apelimit njofton me shkrim apeluesin se kërkesa e tij konsiderohet e paparaqitur.

2.2 Kur kërkesa për apelim përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij kreu, bordi i apelimit e shqyrton kërkesën për apelim brenda një periudhe tremujore nga data e paraqitjes së tij dhe njofton apeluesin për vendimin e marrë. Apeluesi ka të drejtë të ankimojë në gjykatë vendimin e bordit të apelimit që merret mbi një refuzim të bërë në bazë të germës “a” dhe “b” të nenit 180 të ligjit. Vendimet e bordit në lidhje me apelimet e tjera të parashikuara nga kjo rregullore dhe nga ligji janë të formës së prerë.

2.3 Gjatë shqyrtimit, bordi i apelimit ka të drejtë t'i kërkojë apeluesit të vendimit të paraqesë materiale dhe dokumente të tjera shtesë, brenda një periudhe njëmuajore nga data e njoftimit.

3. Trajtimi i aplikimit pas marrjes së vendimit mbi apelimin

3.1 Kur bordi i apelimit vendos të pranojë apelimin dhe vendimi nuk apelohej në gjykatë, një kopje e vendimit të bordit depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe ekzaminuesi vazhdon procedurën për regjistrimin e tij, në përputhje me parashikimet e ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

3.2 Kur bordi i apelimit vendos të rrëzojë apelimin dhe vendimi nuk apelohehet në gjykatë, një kopje e vendimit të bordit depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe refuzimi merr formë të prerë.

3.3 Në rast se vendimi i bordit të apelimit apelohehet në gjykatë, një kopje e vendimit përfundimtar të gjykatës depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe DPPM-ja e refuzon ose e regjistron atë në përputhje me vendimin e gjykatës.

## KREU X

### DOKUMENTE TË TJERA QË LËSHON DPPM-ja LIDHUR ME TREGUESIT GJEOGRAFIKË

#### 1. Ekstaktet dhe hetimet e lëshuara nga regjistri i treguesve gjeografikë

1.1 Në zbatim të nenit 192 paragrafi 2 dhe 194 të ligjit, DPPM-ja u lëshon personave të interesuar ekstrakte nga regjistri i treguesve gjeografikë, si dhe përgjigje të kërkesave për hetim.

1.2 Kërkesa për ekstrakt regjistri për një tregues gjeografik të regjistruar paraqitet pranë DPPM-së me shkrim, shoqëruar me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse, në të kundërt kërkesa quhet e paparaqitur. Ekstrakti i regjistrimit lëshuar nga DPPM-ja përmban të gjitha të dhënat mbi treguesin gjeografik dhe historikun e ndryshimeve që ka pësuar ai.

1.3 Kërkesa për hetim në lidhje me një tregues gjeografik paraqitet pranë DPPM me shkrim, shoqëruar me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse, në të kundërt kërkesa quhet e paparaqitur. DPPM-ja njofton me shkrim paraqitësin e kërkesës lidhur me rezultatin e hetimit.


#### 2. Dublikatet dhe dokumenti i prioritetit

2.1 Pronari i një treguesi gjeografik të regjistruar ka të drejtë të kërkojë dublikatë të certifikatës së regjistrimit ose të njoftimeve të tjera të lëshuara nga DPPM-ja për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin e treguesve gjeografikë. Kërkesa depozitohet me shkrim dhe duhet të shoqërohet me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse, si dhe me autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të treguesit gjeografik, në të kundërt ajo konsiderohet e paparaqitur.

#### 3. Korrigjimi i akteve nga DPPM-ja

3.1 Në rastin e lëshimit nga DPPM-ja të akteve, që përmbajnë gabime ose pasaktësi, jo për fajin e aplikantit ose pronarit të treguesit gjeografik, korrigjimi i tyre bëhet nga DPPM-ja në bazë të një kërkesë me shkrim të paraqitur nga aplikanti ose pronari i treguesit gjeografik. DPPM-ja e rilëshon aktin të korrigjuar, pasi aplikanti ose pronari i treguesit gjeografik ka dorëzuar pranë DPPM origjinalin e aktit për të cilin kërkohet korrigjimi, bën pasqyrimin e korrigjimit në regjistrin e treguesve gjeografikë dhe e publikon atë në Buletinin e Pronësisë Industriale.

## KËRKESË PËR REGJISTRIM TREGUESI GJEOGRAFIK

 <p><b>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE</b> Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 3, Tiranë</p> <p>Tel: +355 42 363 681, Fax: +355 4 2 234 412 Email: mailinf@alpto.gov.al www.alpto.gov.al</p>	<p><i>rezervuar për Zyrën/te mos plotësohet nga aplikanti</i></p> <p>referenca: .....</p> <p>nr i prot: .....</p>
--	---

<p><b>1 PARAQITËSI I KËRKESËS</b></p> <p>a) Emri: .....</p> <p>b) Adresa: ..... <i>(Kodi postar/Qyteti/Shteti)</i> .....</p> <p>c) Adresa për korrespondence: <i>(nëse është e ndryshme nga me sipër)</i> .....</p> <p>d) Telefon : ..... Fax: ..... E-mail: .....</p> <p>e) Statusi Ligjori: .....</p>
---

<p><b>2 PËRFAQËSUESI/PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR</b> <i>(ne rast se ka)</i></p> <p>Emri: .....</p> <p>Adresa: .....</p> <p>Telefon: ..... Fax: ..... E-mail: .....</p> <p><i>(plotësohet vetëm nga përfaqësuesit e licencuar nga Drejtoria)</i></p> <p>Kodi i përfaqësuesit të autorizuar: .....</p>
--

<p><b>3 TREGUESI GJEOGRAFIK</b></p> <p>Shënoni me poshtë treguesin gjeografik për te cilin kërkohet mbrojtja.....</p>
---



**4****RAJONI GJEOGRAFIK**

Shënoni me poshtë territorin e vendit, rajonin, apo lokalitetin ku prodhohet ose përpunohet produkti .....

.....  
.....**5****CILËSIA, REPUTACIONI APO KARAKTERISTIKA TË TJERA**Cilësia, reputacioni apo karakteristika të tjera të mallrave për të cilat treguesi gjeografik është përdorur të tregohen me poshtë:.....  
.....  
..... Vazhdoni në faqen shtesë.**6****LLOJI DHE MËNYRA E PAGESËS****Tarifa baze për tregues gjeografik (----- leke)**

Lloji i dok. të pagesës

dd/mm/vvvv


*(Llogaria bankare në cilën do të kryhet pagesa:  
Degës së thesarit për Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe  
Markave*

----- në çdo Bankë)


**Totali i shumës së paguar**



FAQE SHITESË



## KËRKESË PËR NDRYSHIM EMRI TË PRONARIT ose APLIKANTIT TË TREGUESIT GJEOGRAFIK

 <p>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 3, Tiranë</p> <p>Tel: +355 42 363 681, Fax: +355 4 2 234 412 Email: mailinf@alpto.gov.al www.alpto.gov.al</p>	<p><i>re:ervuar per Zvren/te mos plotesohet nga aplikanti</i></p> <p>referenca: .....</p> <p>nr i prot: .....</p>
---	---

<p><b>1</b> TË DHENA PËR TREGUESIN GJEOGRAFIK</p> <p>NUMRI I KËRKESËS.....</p> <p>NUMRI I REGJISTRIMIT (nëse ka).....</p> <p>DATA E DEPOZITIMIT .....</p> <p>DATA E MBARIMIT TË AFATIT TË REGJISTRIMIT (nëse ka) .....</p>
--

<p><b>2</b> EMRI DHE ADRESA E PRONARIT/APLIKANTIT (Ashtu si është shënuar në regjister/formular).....</p> <p>Emri : .....</p> <p>Adresa: .....</p>
--

<p><b>3</b> EMRI I <u>RI</u> I PRONARIT/APLIKANTIT .....</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>.....</p>
---

<p><b>4</b> PËRFAQËSUESI/PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR (në rast se ka të tillë)</p> <p>Emri: .....</p> <p>Adresa: .....</p> <p>Telefon:..... Fax: .....</p> <p>E-mail: .....</p> <p>.....</p> <p><i>(plotësohet vetem nga përfaqësuesit e licencuar nga DPPM)</i></p> <p>Kodi i Përfaqësuesit të Autorizuar: .....</p>
--

**5**

**LLOJI DHE MËNYRA E PAGESËS**

**Tarifa** per ndryshimin e emrit ----- lekë

Lloji pagesës:

dd/mm/vvvv

.....  
*(Llogaria bankare në cilën do të kryhet pagesa: Degës së thesarit për Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave  
----- në çdo Bankë)*


**6**

**NËNSHKRIMI I PRONARIT / APLIKANTIT / PËRFAQËSUESIT - DATA**

Emër/Mbiemër: .....Data: ..... (dd/mm/vvvv)

Nënshkrimi: .....

## KËRKESË PËR NDRYSHIM ADRESE TË PRONARIT ose APLIKANTIT TË TREGUESIT GJEOGRAFIK

 <p style="margin: 0;">DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE Bulevardi Zhan D'Ark. Nr. 3, Tiranë</p> <p style="margin: 0; font-size: small;">Tel: +355 4 2 362 451, Fax: +355 2 234 412 Email: mailinf@alpto.gov.al www.alpto.gov.al</p>	<p style="text-align: center; font-size: small;"><i>re:ervuar për Zyrën/te mos plotësohet nga aplikanti</i></p> <p>referenca: .....</p> <p>nr i prot: .....</p>
--	---

<b>1</b>	<p><b>TË DHËNA LIDHUR ME TREGUESIN GJEOGRAFIK</b></p> <p>NUMRI I KËRKESËS .....</p> <p>NUMRI I REGJISTRIMIT <i>(nëse ka)</i> .....</p> <p>DATA E DEPOZITIMIT .....</p> <p>DATA E MBARIMIT TË AFATIT TË REGJISTRIMIT <i>(nëse ka)</i> .....</p>
----------	--

<b>2</b>	<p><b>EMRI DHE ADRESA E PRONARIT/APLIKANTIT</b> <i>(Ashtu si është shënuar ne regjistër/formular)</i></p> <p>a) Emri: .....</p> <p>b) Adresa: .....</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p><i>(Kodi postar/Qyteti/Shteti)</i> .....</p> <p>.....</p>
----------	--

<b>3</b>	<p><b>ADRESA E RE E PRONARIT/APLIKANTIT</b></p> <p><input type="checkbox"/> Adresa e re : .....</p> <p>.....</p> <p>Tel: ..... Fax: .....</p> <p>Adresa e-mailit: .....</p>
----------	---

**4****ADRESA PËR KORESPONDENCË***(kur është e ndryshme nga ajo e rubrikës 3)* .....

.....

.....

.....

.....

.....

**5****PËRFAQËSUESI/PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR** *(ne rast se ka te fitte )*

Emri: .....

Adresa: .....

Telefon:..... Fax: .....

E-mail: .....

*(plotësohet vetem nga përfaqësuesit e licensuar nga DPPM)*

Kodi i Përfaqësuesit të Autorizuar: .....

**6****LLOJI DHE MËNYRA E PAGESËS** **Tarifa** për ndryshimin e adresës ----- lekë

Data e pageses: dd/mm/vvvv

Lloji pagesës:


.....

*(Llogaria bankare në cilën do të kryhet pagesa: Degës se thesarit për Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave*

*----- në çdo Bankë)*


**7****NËNSHKRIMI I PRONARIT/APLIKANTIT/PËRFAQËSUESIT – DATA***Emër/Mbiemër*..... *Data:*..... (dd/mm/vvvv)*Nënshkrimi:*.....

## KËRKESË PËR DORËHEQJE NGA TREGUESI GJEOGRAFIK I REGJSTRUAR

 <p>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE Bulevardi Zhan D' Ark. Nr. 3, Tiranë Tel: +355 42 362 451, Fax: +355 4 2 234 412 Email: mailinf@alpto.gov.al www.alpto.gov.al</p>	<p><i>reservuar per Zyren/te mos plotesohet nga aplikanti</i></p> <p>referenca: .....</p> <p>nr i prot: .....</p>
<p><b>1 TË DHËNA PËR TREGUESIN GJEOGRAFIK</b></p> <p>NUMRI I KËRKESËS .....</p> <p>NUMRI I REGJISTRIMIT (nëse ka) .....</p> <p>DATA E DEPOZITIMIT .....</p> <p>DATA E MBARIMIT TË AFATIT TË REGJISTRIMIT (nëse ka) .....</p>	
<p><b>2 EMRI DHE ADRESA E PRONARIT</b> <i>(Ashtu si është shënuar në regjister)</i></p> <p>a) Emri: .....</p> <p>b) Adresa: .....</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p><i>(Kodi postar/Qyteti/Shteti)</i> .....</p>	
<p><b>3 PËRFAQËSUESI/PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR</b> <i>(në rast se ka të tillë)</i></p> <p>Emri: .....</p> <p>Adresa: .....</p> <p>.....</p> <p>Telefon: ..... Fax: ..... E-mail: .....</p> <p><i>(plotësohet vetëm nga përfaqësuesit e licensuar nga DPPM)</i></p> <p>Kodi i Përfaqësuesit të Autorizuar: .....</p>	
<p><b>4 LLOJI DHE MËNYRA E PAGESËS</b></p> <p>Tarifa për dorëheqjen e treguesit gjeografik ----- leke</p> <p>Lloji pagesës: ..... dd/mm/vvvv .....</p> <p><i>(Llogaria bankare në cilën do të kryhet pagesa: Degës së thesarit për Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave në çdo Bankë)</i></p>	
<p><b>5 NËNSHKRIMI I PRONARIT/APLIKANTIT/PËRFAQËSUESIT – DATA</b></p> <p><i>Emër/Mbiemër</i> ..... <i>Data:</i> ..... (dd/mm/vvvv)</p> <p><i>Nënshkrimi:</i> .....</p>	



## KËRKESË PËR KUNDËRSHTIMIN E REGJISTRIMIT TË TREGUESIT GJEOGRAFIK TË PUBLIKUAR

 <p><b>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE</b> Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 3, Tiranë Tel: +355 4 2 362 451, Fax: +355 2 234 412 Email: mailinf@alpto.gov.al www.alpto.gov.al</p>	<p style="text-align: center;"><i>reservuar për Zyrën/te mos plotësohet nga aplikanti</i></p> <p>referenca: .....</p> <p>nr i prot: .....</p>
--	---

<b>1</b>	<b>TË DHËNA LIDHUR ME TREGUESIN GJEOGRAFIK</b> NUMRI I KËRKESËS ..... DATA E DEPOZITIMIT ..... NUMRI DHE DATA E PUBLIKIMIT .....
----------	---

<b>2</b>	<b>EMRI DHE ADRESA E APLIKANTIT</b> a) Emri: ..... ..... b) Adresa .....
----------	---

<b>3</b>	<b>TË DHËNA LIDHUR ME KUNDËRSHTUESIN E RREGJISTRIMIT TË TREGUESIT GJEOGRAFIK TË PUBLIKUAR</b> a) Emri: ..... b) Adresa: ..... ..... c) Tel: ..... Fax: ..... d) E-mail: .....
----------	--

**4 PËRFAQËSUESI/PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR** *(ne rast se ka te tille)*

Emri: .....

Adresa: .....

Telefon: ..... Fax: .....

E-mail: .....

*(plotësohet vetem nga përfaqësuesit e licensuar nga DPPM)*

Kodi i Përfaqësuesit të Autorizuar: .....

**6 LLOJI DHE MËNYRA E PAGESËS**

Tarifa për kundërshtimin e regjistrimit të treguesit gjeografik ----- lekë

dd/mm/vvvv

Lloji pagesës:


.....  
*(Llogaria bankare në cilën do të kryhet pagesa: Degës së thesarit për Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave  
----- në çdo Bankë)*

**6 NËNSHKRIMI I PRONARIT/APLIKANTIT/PËRFAQËSUESIT – DATA**

*Emër/Mbiemër* ..... *Data:* ..... (dd/mm/vvvv)

*Nënshkrimi:* .....

## KËRKESË PËR APELIMIN E VENDIMIT TË REFUZIMIT TË APLIKIMIT TË TREGUESIT GJEOGRAFIK

 <p><b>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE</b> Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 3, Tiranë</p> <p>Tel: +355 4 2 362 451, Fax: +355 2 234 412 Email: mailinf@aloto.gov.al</p>	<p style="text-align: right; font-size: small;"><i>rezervuar për Zyrën/te mos plotësohet nga aplikanti</i></p> <p>referenca: .....</p> <p>nr i prot: .....</p>
--	--

<b>1</b>	<b>TË DHËNA LIDHUR ME TREGUESIN GJEOGRAFIK</b> NUMRI I KËRKESËS ..... DATA E DEPOZITIMIT ..... DATA E REFUZIMIT TE APLIKIMIT.....
----------	--

<b>2</b>	<b>EMRI DHE ADRESA E APELUESIT</b> a) Emri: ..... ..... b) Adresa ..... .....
----------	---

<b>3</b>	<b>PËRFAQËSUESI/PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR</b> <i>(ne rast se ka te fille)</i> Emri: ..... Adresa: ..... ..... Telefon: ..... Fax: ..... E-mail: ..... ..... <p style="font-size: x-small;"><i>(plotësohet vetëm nga përfaqësuesit e licencuar nga DPPM)</i></p> Kodi i Përfaqësuesit të Autorizuar: .....
----------	--

<b>4</b>	<b>LLOJI DHE MËNYRA E PAGESËS</b> Tarifa për apelimin e vendimit te refuzimit te aplikimit te treguesit gjeografik ----- leke
----------	--

Lloji pagesës:

dd/mm/vvvv

.....  
(Llogaria bankare në cilën do të kryhet pagesa: Degës se thesarit për Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave  
..... në çdo Bankë)

**5**

**NËNSHKRIMI I PRONARIT/APLIKANTIT/PËRFAQËSUESIT – DATA**

*Emër/Mbiemër*..... *Data*:..... (dd/mm/vvvv)

*Nënshkrimi*:.....